

Bobovac. Në bazë të analizave mjekësore të ekspertëve të Zyrës së UNMIK-ut për Persona të Zhdukur në vitin 2004, vdekja e Ajetit ka rezultuar nga plagët e shumta në kokë dhe trup, të cilat ishin të shkaktuara nga armë zjarri.

Burimet: deklarata S.G, FDH-33835; ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 30.11.2005, [http://www.hlc-rcd.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=1-19&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drug-i-\(-IT-03-66-\);](http://www.hlc-rcd.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=1-19&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drug-i-(-IT-03-66-);) USCG KGDH, *Regjistri..*, FDH-8817; *Teroristi muçili i ubili 67 nedužnih civila*, Politika, 14.9.1998, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/1998-09/17/5250.html>; *Mutilated Body of Albanian Spotted in Fields of Lipjan Village*, pasqyra e lajmeve, KIC, 14.06.1998, FDH-29319.

Skender (Mehmet) Fejzullahu

(1.02.1972, shqiptar nga Zabeli i Ulët/Donji Zabelj, komuna e Glogocit/Glogovac, tekniku i metalurgjisë)

Skënderi jetonte në bashkësi me vëllezërit Rrahimin, Rrahmanin dhe Enverin me familjet në Zabelin e Ulët/Donji Zabelj. Që të gjithë u detyruan t'i braktisnin shtëpitë e veta më **29.05.1998**, kur forcat serbe depërtuan në Zabelin e Ulët/Donji Zabelj dhe urdhëruan që fshatarët të largoheshin nga fshati. I gjithë fshati u nis drejt Vasilevës/Vasiljevo. Përderisa po kalonin pranë livadheve të fshatit [**Zabeli i Ulët/Donji Zabelj**], Skënderin e ka qëlluar një plumb snajperi dhe e ka plagosur rëndë. Të afërmit e kanë çuar në fshatin Korroticë të Poshtme/Donja Koretica dhe e vendosën në shtëpinë e Xhemal Rexhepit. Më pas, e çuan në spitalin e UÇK-së në Likoc/Likovac [Skënderaj/Srbica]. Një muaj më vonë, më 27.06.1998, Skënderi ndërroi jetë nga plaga e rëndë. Po atë ditë, e varrosën në varrezat e fshatit të lindjes të Zabelit të Ulët/Donji Zabelj.

Burimi: deklarata H.F, FDH-17982.

Sami (Firiz) Bogiqi

(9.08.1961, shqiptar nga fshati Vukovc/Vukovce, komuna e Glogocit/Glogovac, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Samiu ka qenë kuzhinier në UÇK. Largohej shpesh nga pozicionet që ta vizitonte familjen. Në datën **29.05.1998** dhe duke mos ditur se familjarët e tij e kishin braktisur fshatin, ai, si zakonisht, u nis për një vizitë të familjarët e vet. Në vendin e quajtur *Fusha e Vukovcit/Vukovačka polja* [**Vukovc/Vukovce**], ai u ndesh me pjesëtarë të forcave serbe, të cilët menjëherë shtënën drejt tij. Samiu u qëllua për vdekje në vend. Tri ditë më vonë, më 1.06.1998, bashkëluftëtarët e Samiut e kanë varrosur atë në varrezat e Llapushnikut/Lapušnik. Mbetjet e tij mortore janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Negroc/Negrovce më 5.09.2000.

Burimet: deklarata A.B, FDH-25885; J. Martinsen, *Regjistri..*, FDH-26092; fotografi, FDH-20112.

Tomislav (Branislav) Fatić

(6.08.1973, serb nga Peja/Peć, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Tomislavi e ka mbaruar trajnimin për oficer police. Në MPB-në e Serbisë ka filluar nga puna në vitin 1994. Ishte me detyrë në Stacionin Policor të Glogocit/Glogovac. E ka humbur jetën në fshatin **Poklek** më **31.05.1998**.

Burimet: SMIP, *Teroristički..*, III, 379, 933; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 72; KMKKRFJ, *Personat..*, FDH-10832; *Dnevnik od 25.maja do 1.juna*, Ilustrovana politika, 6.06.1998, FDH-16958; KMDLNI, *Buletini*, br. 9, tetor-dhjetor 1998, 168-169, FDH-23816.

Sahit (Musli) Qorri

(19.10.1940, shqiptar nga Pokleku i Ri/Novi Poklek, komuna e Glogocit/Glogovac, tregtar, shtatë fëmijë)

Ramë (Miran) Asllani

(10.02.1944, shqiptar nga Pokleku i Ri/Novi Poklek, komuna e Glogocit/Glogovac, punëtor ndërtime, pesë fëmijë)

Sefer (Brahim) Qorri

(12.03.1945, shqiptar nga Pokleku i Ri/Novi Poklek, komuna e Glogocit/Glogovac, punëtor, shtatë fëmijë)

Hajriz (Ejup) Hajdini

(20.07.1950, shqiptar nga Pokleku i Ri/Novi